

VENDIM
Nr. 290, datë 24.4.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 875, DATË 11.11.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI ‘NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 400/110/20 kV, TIRANA 3’”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 875, datë 11.11.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti ‘Ndërtimi i nënstacionit 400/110/20 kV, Tirana 3’”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikat 3 dhe 4, vlera “... 18 711 640 (tetëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet) lekësh ...” zëvendësohet me “... 55 975 672 (pesëdhjetë e pesë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy) lekësh ...”;

b) Tabela, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pronarët e pasurive, që korrespondojnë me numrat rendorë 7, 10, 11 dhe 13 të tabelës, bashkëlidhur vendimit nr. 875, datë 11.11.2020, të Këshillit të Ministrave, që janë likuiduar sipas vlerës së përcaktuar para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, vetëm për diferencën e vlerës së shtuar të kompensimit, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 400/110/20 kV, TIRANA 3”

Nr. rendor	Pronësia	Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)				Kompensimi sipas standardit ndërkombëtar (vlera në lekë)			Shënime
	Emër Mbiemër	Lloji i pasurisë	ZK	Nr. pasurie	Sip. e pronës (m ²)	Sip. që shpronësohet (m ²)	Çmimi i tokës (lekë/m ²) llogaritur sipas raportvlerësimit të përgatitur nga ekspertët vlerësues	Vlera e kompensimit sipas standardit ndërkombëtar (në lekë)	
1	Qemal Metoja	Arë	2947	371/5	9,200	9,200	1,406	12,935,200	

	Artur Xhezmi Sinanaj Ferdinand Xhezmi Sinoma	Arë	2947	371/6	9,000	9,000	1,406	12,654,000	
3	Myrteza Gjashta	Arë	2947	371/11	8,000	1,700	1,406	2,390,200	
4	Mustafa Mahmut Kupa	Arë	2947	371/12	3,450	3,450	1,406	4,850,700	
5	Aqif Maliq Sina, Shaban Maliq Sina	Arë	2947	371/13	4,039	4,039	1,406	5,678,834	
6	Aqif Maliq Sina, Shaban Maliq Sina	Arë	2947	371/14	500	500	1,406	703,000	
7	Valbona Lalaj	Arë	2947	371/15	1,500	1,500	1,406	2,109,000	
8	Muhamet Abdulla Zaja	Arë	2947	371/16	5,000	5,000	1,406	7,030,000	
9	Aqif Maliq Sina, Shaban Maliq Sina	Arë	2947	371/17	261	261	1,406	366,966	
10	Jakup Kupi	Arë	2947	371/18	2,000	2,000	1,406	2,812,000	
11	Mustafa Isak Doda	Arë	2947	371/19	2,000	2,000	1,406	2,812,000	
12	Fatmir Maliq Çejku, Ylber Maliq Çajku, Nexhmije Maliq Gjana, Hatije Maliq Domi, Meriman Maliq Çejku, Fitore Maliq Cela, Luan Maliq Çajku, Abaz Maliq Çejku	Arë	2947	5/1/6	14,950	457	1,406	642,542	
13	Bashkim Isuf Kupi	Arë	2947	5/1/30	220	220	1,406	309,320	
14	Isuf Jakup Kupi	Arë	2947	5/1/8	1,000	41	1,406	57,646	
15	Mustafa Mahmut Kupi	Arë	2947	5/1/9	9,950	444	1,406	624,264	
Sipërfaqe totale shpronësimi (m²)						39,812			
Nënstacioni 400/110/20 kV, Tirana 3 – shuma e kompensimit (lekë)								55,975,672	